

# Heqja e Tarifave të Romingut si hap drejt integrimin ekonomik Kosovë-Shqipëri

**RKS**



**ALB**

Tetor 2014



GAP INSTITUTE  
INSTITUTI GAP

Seria e analizave mbi integrimin  
ekonomik Kosovë-Shqipëri #1

# Heqja e Tarifave të Romingut

## si hap drejt integritimit ekonomik Kosovë-Shqipëri

### I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në mesin e shumë marrëveshjeve të nënshkruara në mes të Kosovës dhe Shqipërisë është edhe ajo për bashkëpunim në fushën e teknologjisë dhe informacionit. Sipas kësaj marrëveshjeje, të dy shtetet do të angazhohen për uljen e tarifave të romingut sipas modelit të BE-së. Që nga nënshkrimi i marrëveshjes në mars 2013, asgjë konkrete nuk është arritur. Qytetarët e Kosovës dhe Shqipërisë vazhdojnë të paguajnë tarifa shumë të larta të romingut, këndeje e andej kufirit. Përderisa BE po shkon drejt eliminimit total të tarifave të romingut, në Kosovë dhe Shqipëri shfrytëzuesit e telefonisë mobile paguajnë tarifa të romingut deri në tetë herë më të shtrenjta se qytetarët e BE-së. Duke qenë se qeveritë e dy vendeve veç kanë shprehur vullnet politik për ta adresuar këtë problem, Instituti GAP kërkon që rregullatorët e dy shteteve të ndërmarrin hapa konkret, fillimisht drejt uljes së tarifave dhe përfundimisht drejt heqjes së tarifave të romingut për arsye se a) tarifat e romingut janë shumë të larta në krahasim me ato të BE-së; b) intervenimi për uljen e tarifave është një praktikë e BE-së që ka për qëllim mbrojtjen e konsumatorit; dhe c) ulja e kostonë së komunikimit rrit edhe më tej bashkëpunimin tregtar dhe rrit komunikimin në mes të dy vendeve. Kjo rritje e komunikimit (trafikut të telefonisë mobile) sigurisht se do të kompensonte humbjet që mund të kenë operatorët telefonik nga ulja e tarifave të romingut. GAP mbështet idenë për heqjen e tarifave të romingut në nivel të përgjithshëm rajonal, por sugjeron që kjo më parë të bëhet në mes të Kosovës dhe Shqipërisë.

## II. HYRJE

Tarifat e romingut ndërmjet shteteve ballkanike janë disa herë më të larta se tarifat për thirrje lokale dhe shumë më të larta se sa tarifat e romingut të aplikuar në shtetet anëtare të BE-së. Ky problem është adresuar nga Instituti GAP edhe në vitin 2011, dhe që atëherë shumë pak ka ndryshuar sa i përket tarifave të romingut. Në analizën me titull [Ngritja e bashkëpunimit rajonal: ulja e tarifave të romingut në Ballkanin Perëndimor](#)<sup>1</sup>, Instituti GAP kishte analizuar tarifat e romingut që shtetet e Ballkanit Perëndimor (pa Kroacinë) aplikojnë për njëri-tjetrin. Të gjeturat e studimit tregonin se tarifat e romingut në disa raste ishin 29 herë më të larta se tarifat për thirrje lokale. Atë kohë, Instituti GAP rekomandoi që shtetet e Ballkanit Perëndimor, deri në momentin e anëtarësimit në BE, të krijojnë zonën “Ballkantarif”, me ç'rast qeveria e Shqipërisë, Kosovës, Serbisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Bosnjë e Hercegovinës do t'i detyronin operatorët vendor mobil që t'i ulnin tarifat e romingut mes vete dhe të vendosin limite rreth maksimumit të tarifave për roming.

Më 21 gusht 2014, Agjencia për Komunikime Elektronike e Maqedonisë ka organizuar një takim rajonal për të gjetur një model bashkë me shtetet e rajonit për të hequr tarifat e romingut. Kjo iniciativë është në përputhje me rekomandimin e Institutit GAP të vitit 2011. Por, meqë ky takim është mbajtur nën patronatin e BEREC/IRG<sup>2</sup>, ku Kosova dhe Bosnja nuk kanë të drejtën e pjesëmarrjes<sup>3</sup>, lë të kuptohet se nuk është e sigurt nëse edhe Kosova do të jetë pjesë e një marrëveshjeje eventuale për heqjen e tarifave të romingut.

Andaj, në këtë analizë, Instituti GAP hedh idenë që të paktën Shqipëria dhe Kosova do duhej të hiqnin tarifat e romingut në mes vete. Këtu kemi ofruar tri argumente se përse një gjë e tillë do duhej të ndodhë sa më parë:

- a) politikisht një gjë e tillë është e mundur sepse dy qeveritë kanë shprehur vullnet kur kanë nënshkruar marrëveshjen për bashkëpunim në fushën e TIK<sup>4</sup>;

<sup>1</sup> Analizën e plotë mund ta lexoni në: <http://bit.ly/1lxHcXd> (hapur së fundmi më 28.8.2014).

<sup>2</sup> BEREC është shkurtesë për Body of European Regulators for Electronic Communication.

<sup>3</sup> Shih për më shumë komunikatën për opinion të ARKEP në lidhje me këtë takim të datës 22 gusht 2014: <http://bit.ly/1vSFyQl> (hapur së fundmi më 28 gusht 2014).

<sup>4</sup> Sipas Ligjit për Komunikimet Elektronike Qeveria miraton politikat dhe strategjitë kombëtare për aktivitetet në fushën e komunikimeve

- b) standardizimi i tarifave nuk është në kundërshtim me politikat e BE-së, përkundrazi ulja (heqja) e tarifave të romingut është praktikë e BE-së;
- c) zvogëlimi sezonal i tarifave të romingut gjatë verës nuk paraqet një zgjidhje afatgjate për konsumatorët.

Në vazhdim do të shpjegojmë të tri këto argumente.

### III. BASHKËPUNIMI SHQIPËRI-KOSOVË

Në dokumentin e titulluar si Marrëveshje Bashkëpunimi Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Bashkëpunim në Fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit (TIK), i nënshkruar më 19 mars 2013, qeveritë e dy vendeve zotohen se do të angazhohen bashkërisht për zvogëlimin e tarifave të romingut, bazuar në Rregulloren për Roming të Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 13 qershor 2012.<sup>5</sup>

Kjo marrëveshje nënkupton se ulja e tarifave të romingut tashmë ka hyrë në agjendën e dy qeverive dhe ky premtim do të duhej të përmbushej për aq sa është e vlefshme kjo marrëveshje.<sup>6</sup> Gjatë viteve 2009-2014, Qeveria e Kosovës dhe Qeveria e Shqipërisë kanë nënshkruar gjithsej 20 marrëveshje mes vete, duke përfshirë marrëveshje që kanë të bëjnë me bashkëpunim doganor, bashkëpunim në arsim, shkëmbim të informacionit, etj.<sup>7</sup> Zvogëlimi apo heqja e tarifave të romingut është pjesë e krijimit të një tregu të përbashkët ndërmjet shteteve. Shqipëria dhe Kosova veç kanë nënshkruar disa marrëveshje që qojnë në këtë drejtim.<sup>8</sup>

Disa nga këto marrëveshje kanë filluar të zbatohen, duke ofruar lehtësime për qytetarët dhe afaristët e bizneseve nga të dyja vendet. Ngjashëm, edhe marrëveshja për bashkëpunim në fushën e TIK, duke përfshirë edhe pjesën për zvogëlim të

---

elektronike, kurse Rregullatori duhet të bëjë implementimin e politikave të tilla.

<sup>5</sup> Rregulloren e plotë mund ta gjeni në <http://bit.ly/1nxfQNq> (hapur së fundmi më 28.8.2014).

<sup>6</sup> Neni 7 i marrëveshjes për bashkëpunim thotë se 'Kjo MP hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe është e vlefshme për katër vjet. Kjo MP mund të shtyhet për një periudhë tjetër dyvjeçare, përveç kur njëra nga palët e përfundon atë'.

<sup>7</sup> Për më shumë rreth marrëveshjeve shih në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

<sup>8</sup> Në mbledhjen e përbashkët të dy qeverive në Prizren, u nënshkrua marrëveshja për nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë mes dy shteteve (<http://bit.ly/1zJb7fJ>); apo marrëveshja për transportin dhe qarkullimin e lirë e nënshkruar në po këtë mbledhje (<http://bit.ly/1vp6Eku>).

tarifave të romingut mund të implementohet. Për më tepër, Rregullorja për Roming e Këshillit të Bashkimit Evropian, të cilës i referohen palët nënshkruese, ofron disa argumente se përse duhen të zvogëlohen apo të largohen krejtësisht tarifatat e romingut.

Sipas kësaj Rregulloreje, tarifatat e larta të romingut paraqesin një pengesë për përdorimin e telefonisë mobile nga ana e studentëve, afaristëve të biznesit dhe turistëve në udhëtimet e tyre brenda Bashkimit Evropian. Këto tarifatat e larta janë një barrierë serioze për tregun e përbashkët të 500 milion konsumatorëve. Andaj, ndër objektivat kryesore të kësaj Rregulloreje është zvogëlimi i diferencës në mes të tarifave lokale dhe atyre të romingut, gjë që do të ndihmonte në krijimin e një tregu të përbashkët të shërbimeve për komunikim mobil. Tarifatat e larta të romingut janë një pengesë për përpjekjet e BE-së për t'u zhvilluar në një ekonomi të bazuar në dije dhe drejt zhvillimit të një tregu të përbashkët.

Andaj, heqja e tarifave të romingut do të lehtësonte komunikimin mes dy shteteve, dhe krahas implementimit të politikave për bashkëpunim në fushën e ekonomisë, dijes dhe infrastrukturës, qeveritë e të dyja vendeve duhet të implementojnë edhe politika për heqjen e tarifave të romingut.

#### IV. POLITIKAT E BE-SË MBI ROMINGUN

Me qëllim të mbrojtjes së konsumatorit dhe lehtësimit të komunikimit, Bashkimi Evropian ka ndërmarrë një varg masash për zvogëlimin e tarifave të romingut që ka quar deri në eliminimin e tërësishëm të tyre. Që nga viti 2007, me tri rregullore të ndryshme, Komisioni Evropian ka zbritur tarifatat e romingut për thirrje dhe SMS në mënyrë drastike dhe është në proces të eliminimit total të tarifave të romingut. Kështu në vitin 2007, u vendosen kufizimet e para të tarifave të romingut në atë që u bë e njohur si “Eurotariff”.<sup>9</sup> Dy vite më vonë, Komisioni Evropian nxori rregulloren e dytë, e cila edhe më tej uli tarifatat e romingut për thirrje dhe SMS.<sup>10</sup> Kjo rregullore njihet si “Euro SMS tariff”. Më 2012, edhe më tej u ulën tarifatat e romingut për thirrje, SMS dhe internet.<sup>11</sup> Tabela në vazhdim

<sup>9</sup> Shih Rregulloren nr.717/2007: <http://bit.ly/1AWCSUI> (hapur së fundmi më 28.8.2014).

<sup>10</sup> Shih Rregulloren nr.544/2009: <http://bit.ly/1zJdiOw> (hapur së fundmi më 28.8.2014).

<sup>11</sup> Shih Rregulloren nr.531/2012: <http://bit.ly/1nxfQNq> (hapur së fundmi më 28.8.2014).

pasqyron uljen graduale të çmimeve të romingut në shtetet e BE-së.

Tabela 1: Tarifat e romingut (pa TVSH) brenda BE 2007-2014

	Thirrjet	Pranimi i thirrjes	Dërgimi i SMS	Pranimi i SMS
2007	0.49	0.29	0.28	Falas
2008	0.46	0.22	0.28	Falas
2009	0.43	0.19	0.11	Falas
2010	0.39	0.15	0.11	Falas
2011	0.35	0.11	0.11	Falas
2012	0.29	0.08	0.09	Falas
2013	0.24	0.07	0.08	Falas
2014	0.19	0.05	0.06	Falas

Burimi: Komisioni Evropian - Agjenda Digjitale për Evropën

Që nga viti 2007, BE ka ulur çmimet për thirrje dhe SMS në roming për mbi 80%, ndonëse edhe kjo është ende larg nga synimi i Agjendës Digjitale për Evropën, e cila parasheh që dallimi mes tarifave të romingut dhe tarifave lokale deri më 2015 duhet të jetë afër zeros. Gjatë vitit 2014, Parlamenti Evropian ka aprovuar një pako të re legislative për krijimin e një tregu të vetëm të telekomunikimit e cila parasheh heqjen e tarifave të romingut për 28 shtetet e BE-së deri në dhjetor 2015. Një vendim i tillë nga Komisioni Evropian është konsideruar si “largim i barrierave për ta bërë jetën më të lehtë dhe më pak të kushtueshme”.<sup>12</sup>

## V. TARIFAT E ROMINGUT SHQIPËRI-KOSOVË

Krahasuar me tarifata lokale, operatorët e telefonisë mobile në Shqipëri dhe Kosovë aplikojnë tarifa shumë të larta. Të hyrat që operatorët realizojnë përmes romingut nuk paraqesin të hyrat kryesore të operatorëve. Në rastin e BE-së, romingu përbën vetëm 10% të të ardhurave të operatorëve të BE-së, kurse konsumatorët, edhe përkundër tarifave të volitshme të romingut, paguajnë çmimin dyfish më shtrenjtë për thirrje në roming (çmimi *retail*) se sa që paguajnë vetë operatorët për çmimin me shumicë (çmimi *wholesale*).<sup>13</sup>


Numri i përgjithshëm i përdoruesve të telefonisë mobile në vitin 2013 në Kosovë ishte 1,643,429 përdorues.<sup>14</sup>

Grafikoni 1: Ndarja e tregut të telefonisë mobile sipas operatorëve në 2013

<sup>12</sup> Deklarata e Neelie Kroes, zv. Presidente e Komisionit Evropian. Shih në <http://reut.rs/VPe1md> (hapur së fundmi më 28.8.2014).

<sup>13</sup> Shih <http://bit.ly/1qjzzCa> (hapur së fundmi më 28.8.2014).

<sup>14</sup> ARKEP: Raporti Vjetor 2013. Burimi: <http://bit.ly/XaUVY6> (hapur së fundmi më 16.9.2014).



Burimi: ARKEP

Si Vala ashtu edhe IPKO aplikojnë tarifa mjaft të larta të romingut në krahasim me thirrjet lokale. Në krahasim me tarifatat që aplikohen në shtetet e BE-së, përdoruesit e telefonisë mobile të Vala-s dhe IPKO-s paguajnë gati katër herë më shtrenjtë për thirrje. Dhe kjo gjendje është sa i përket marrëveshjeve që kanë operatorët në mes vete. Nëse klientët e Vala-s dhe IPKO-s nga pakujdesia ose mosdija lidhen me një operator tjetër, ata paguajnë deri në tetë herë më shtrenjtë për thirrje se sa që paguajnë qytetarët në vendet e BE-së.

Edhe Vala edhe IPKO kanë marrëveshje me operatorë të Shqipërisë, përmes të cilëve çmimet për roming janë gati përgjysmë më të lira në krahasim me operatorët me të cilët nuk kanë marrëveshje.<sup>15</sup>

Tabela 2: Çmimet e roming-ut nga Shqipëria në Kosovë të operatorit VALA<sup>16</sup> dhe IPKO<sup>17</sup>

Vala roming	Nga Shqipëria (Plus) në Kosovë	Thirrja	Pranimi i thirrjes	SMS	GPRS
		0.80 €	0.25 €	0.19 €	7.25 €/1 MB
	Nga operatorët tjerë të Shqipërisë në Kosovë	1.75 €	0.50 €	0.50 €	11.6 €/1MB €
Ipko roming*	Nga Shqipëria (Eagle) në Kosovë	Thirrje	Pranimi i thirrjes	SMS	GPRS
		0.80 €	0.45 €	0.40 €	2€/100KB
	Nga operatorët tjerë të Shqipërisë në Kosovë	1.67 €	0.45 €	0.40 €	2€/100KB

<sup>15</sup> Vala ka marrëveshje me operatorin Plus, kurse IPKO ka marrëveshje me operatorin Eagle Mobile.

<sup>16</sup> <http://bit.ly/1C5kWI0> (hapur së fundmi më 28.8.2014).

<sup>17</sup> <http://bit.ly/1q7wAOL> (hapur së fundmi më 28.8.2014).

\* Gjatë muajve të verës IPKO ofron çmime të romingut 50% më lirë përmes Eagle Mobile, por kjo ofertë vlen vetëm dy orë në ditë (18:00-20:00) dhe vlen deri më 01.10.2014. IPKO ka edhe një ofertë për data roming që e kemi cekur më poshtë.

Tarifa gati të njëjta paguajnë edhe klientët e Plus dhe Eagle Mobile kur vizitojnë Kosovën, siç tregon tabela në vazhdim.

Tabela 3. Çmimet e roming-ut nga Kosova në Shqipëri

Operatorët	Thirrje	Pranimi i thirrjes	SMS	GPRS
<b>Eagle Mobile (përmes IPKO)</b>	60 lekë (0.42 €)	60 lekë (0.42 €)	16 lekë (0.11 €)	/
<b>Plus (përmes Vala)</b>	122.6 lekë (0.88 €)	37 lekë (0.26 €)	26 lekë (0.19 €)	1.050 lekë (7.5€ ) MB

Përfundimisht, çmimet e larta të romingut që aplikohen në mes të dy shteteve pengojnë komunikimin dhe shfrytëzimin e shërbimeve të romingut. Me këso çmimesh, shumë klientë do të preferonin të mos shfrytëzonin romingun se sa të paguanin tarifa të tilla. Operatorët në Kosovë më shumë përfitojnë nga romingu kur të tjerët vizitojnë Kosovën se sa kur klientët e tyre dalin jashtë shtetit. Por, edhe kur ata shfrytëzojnë romingun jashtë shtetit më shumë të hyra vinë nga shtete si Kanadaja, SHBA, Mbretëria e Bashkuar se sa nga Shqipëria<sup>18</sup>. Sikur Kosova dhe Shqipëria të largonin shërbimin e romingu mes vete, prapë se prapë operatorët e tyre do të gjeneronin të hyra nga romingu me shtetet tjera.

Në anën tjetër, ofertat verore (Vala nuk ka fare ofertë verore kurse oferta e IPKO<sup>19</sup> vlen vetëm për dy orë në ditë), tani po sfidohen nga operatorët mobil të Shqipërisë, të cilët në formë të promocionit ofrojnë për pushuesit kosovar SIM kartela, të cilët përfshijnë edhe MB dhe SMS falas. Oferta të tilla sfidojnë klientët e Vala-s dhe IPKO-s që fare të mos i shfrytëzojnë shërbimet e romingut në Shqipëri, të cilat edhe ashtu janë shumë të shtrenjta në krahasim me tarifat vendore. Ndërkaq, numri i kosovarëve që vizitojnë bregdetin shqiptar po rritet nga viti në vit. Vetëm gjatë muajve qershor-gusht 2014 rreth 760 mijë kosovarë kanë vizituar Shqipërinë<sup>20</sup>.

<sup>18</sup> ARKEP: Raporti Vjetor 2013. Burimi: <http://bit.ly/XaUVY6> (hapur së fundmi më 16.9.2014).

<sup>19</sup> IPKO ka edhe një ofertë tjetër që ka të bëjë me data roming, ku njëra është pako ditore (150MB/1.5 euro) dhe tjetra është pako mujore 2GB/10 euro).

<sup>20</sup> <http://bit.ly/1thcjt9> (hapur së fundmi më 16.09.2014).



## VI. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

- Në vitin 2011, Instituti GAP ka publikuar një studim që tregon se tarifafat e romingut ndërmjet shteteve të Ballkanit Perëndimor janë deri në 29 herë më të shtrenjta se ato që aplikohen në shtetet e BE-së. Andaj, Instituti GAP ka propozuar që shtetet e Ballkanit Perëndimor të anëtarësohen sa më parë si bllok në zonën e Eurotarif, ose të krijojnë një 'Ballkantarif' zonë, ku sipas modelit të BE-së, do të ulnin dhe të vendosnin limite të tarifave të romingut.
- Në verën e vitit 2014, Agjencia për Komunikime Elektronike e Maqedonisë ka marrë iniciativën që të negociojë me rregullatorët kombëtar të shteteve të Ballkanit Perëndimor për të gjetur një model përmes të cilit do të ulen/të hiqen tarifafat e romingut për vendet e rajonit.
- Instituti GAP mbështet një iniciativë të tillë, por derisa kjo iniciativë të konkretizohet me një marrëveshje rajonale, GAP rekomandon që, pavarësisht iniciativës rajonale, Qeveria e Shqipërisë dhe ajo e Kosovës duhet të qojnë përpara iniciativën e filluar në vitin 2013 për angazhimin e përbashkët për uljen e tarifave të romingut.
- Ofertat verore dhe marrëveshjet bilaterale që kanë mes vete operatorët nga Shqipëria dhe Kosova, nuk janë të mjaftueshme dhe tarifafat janë të larta për konsumatorët.
- Operatorët mobil të Kosovës dhe Shqipërisë nuk është që gjenerojnë edhe aq shumë të hyra nga romingu, ngase për shkak të tarifave të larta qytetarët shfrytëzojnë romingun shumë pak. Dhe në anën tjetër, humbjet që mund të shkakttoheshin nga një marrëveshje e tillë, do të mund të kompensoheshin nga romingu me shtetet tjera.

Andaj, për ta adresuar këtë çështje Instituti GAP rekomandon që:

- Qeveria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë ta themelojnë një grup punues për të koordinuar aktivitetet mes vete për implementimin e plotë të pikave të marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e TIK, e sidomos mbi pikën për zvogëlimin e tarifave të romingut.

- Në përputhje me Rregulloren e Këshillit të Bashkimit Evropian për Roming (13 qershor 2012), rregullatorët e dy shteteve duhet fillimisht të vendosin limite rreth tarifave të romingut që operatorët mund të aplikojnë për njëri tjetrin. Këto tarifa duhet të jenë të ngjashme me ato të BE-së për vitin 2014. Kjo zbritje do duhej të qonte drejt heqjes totale të tarifave të romingut në mes të dy shteteve në të ardhmen e afërt.
- Shqipëria dhe Kosova duhet të ndjekin shembullin e BE-së për të krijuar një treg të përbashkët të telekomunikimit me një marrëveshje të tillë bilaterale e cila do të vlente deri në anëtarësimin e të dy vendeve në BE.

Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

**Instituti për Studime të Avancuara GAP përkrahet nga:**

